

ASC-09-0041

Në padinë e

[REDACTED] nga Gllgovci

Paditësja/Ankuesja

kundër

1) Ndërmarrja Shoqërore Bujqësore [REDACTED]
Gllgovc

Të Paditurit

2) Agjencia Kosovare e Mirëbesimit
Prishtinë

Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS), i përbërë nga Richard Winkelhofer, Kryetar i DHPGJS-së, si Gjyqtar Kryesues, Torsten Frank Koschinka dhe Eija-Liisa Helin, Gjyqtarë, në ankesën e Paditëses/Ankueses kundër aktvendimit të DHPGJS-së të datës 23 korrik 2009, SCC-08-0257, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 17 gusht 2010, jep këtë

AKTVENDIM

1. Refuzohet kërkesa për ndihmë në përkthime.
2. Ankesa hedhet poshtë si e papranueshme.
3. Ankuesja është e obliguar që të paguaj për Dhomën e Posaçme taksën gjyqësore në shumë prej 60 Euro për procedurën e ankesave.

Rrethanat procedurale:

Më 15 shtator 2008 Paditësja ushtroi padi në DHPGJS duke kërkuar njohjen e të drejtave pronësore mbi pasurinë e patundshme.

Paditësja është përfaqësuar nga avokati i autorizuar në mënyrë të rregullt.

Më 23 korrik 2009 Trupi Gjykses lëshoi një aktvendim për këtë çështje, me të cilin e hodhi poshtë padinë si të papranueshme në bazë të neneve 28.3 dhe 28.4 të Urdhëresës Administrative (UA) të UNMIK-ut 2008/6, duke argumentuar se Paditësja nuk e kishte përmbushur tërësisht urdhrin e Gjyqtarit Raportues i cili kishte kërkuar disa dokumente nga Paditësja.

Më 4 gusht 2009 Paditësja (më tej Ankuesja) ushtroi ankesë kundër aktvendimit të përmendur të Trupit Gjykses me të cilin kërkoi që të anulohet aktvendimi dhe që të kthehet lënda tek Trupi Gjykses për të vazhduar procedurat.

Kolegji i Ankesave urdhëroi Ankuesen që të plotësojë ankesën e saj duke kërkuar nga ajo që në bazë të nenit 60.2 të UA UNMIK-ut 2008/6 të dorëzojë një kopje të aktvendimit kundër të cilit është ngritur ankesa dhe që të dorëzojë në bazë të nenit 25.7 të të njëjtit UA përkthimin në gjuhën angleze të ankesës dhe të dokumenteve mbështetëse. Urdhri e paralajmëroi Ankuesen se nëse ajo nuk e përmbushte atë, Kolegji i Ankesave do ta refuzojë ankesën mbi bazat e papranueshmërisë. Gjithashtu, Ankuesja u informua për nenin 25.8 të UA UNMIK-ut 2008/6 sipas të cilit pala që është person fizik mund të dorëzojë një kërkesë tek Gjyqtari Kryesues për ndihmë në përkthimin e parashtresave dhe dokumenteve mbështetëse. Mosplotësimi i formularit do të shpie në refuzimin e ankesës. Urdhri, përkthimi i tij dhe formulari për ndihmë në përkthim i janë dërguar avokatit të Ankueses më 30 Dhjetor 2009.

Ankuesja paraqiti parashtresën në kohë, por nuk e dorëzoi kopjen e aktvendimit kundër të cilit është ngritur ankesa dhe përkthimin e kërkuar të ankesës në gjuhën angleze. Ajo nuk dorëzoi as kërkesën për shabllonin zyrtar (ZPF 1) për të kërkuar ndihmë në përkthim. Por, ajo u përgjigj se në shkresat e lëndës veçse

III

gjendet përkthimi në gjuhën angleze i padisë dhe i tërë dokumenteve të nevojshme. Nëse do të nevojitej përkthim, Ankuesja kërkon nga DHPGJS-ja që të caktojë "një përkthyes zyrtar" për arsye se Ankuesja nuk ka mjete që të paguaj shpenzimet e përkthimit. Sipas përgjigjes Ankuesja jeton me ndihmë sociale pa të ardhura tjera apo ndonjë pronë.

Me urdhrin e Kolegjit të Ankesave të datës 21 prill 2010 nga Ankuesja u kërkua që të dorëzojë prova kompetente dhe të qarta se ajo ka të drejtë të marrë ndihmë sociale dhe edhe një herë një kopje të aktvendimit kundër të cilit është ngritur ankesa. Ankuesja edhe një herë u paralajmërua për pasojat ligjore të mospërmbushjes së urdhrin. Më 23 prill 2010 Ankuesja paraqiti parashtresë, por nuk dorëzoi as ndonjë provë se Ankuesja jeton nga ndihma sociale e as kopjen e aktvendimin të Trupit Gjykses kundër të cilit është ngritur ankesa.

Arsyet ligjore:

Ankesa është ushtruar më kohë, por është e papranueshme.

Ankesa nuk i plotëson kushtet e parapara me nenet 60.2 dhe 25.7 të UA UNMIK-ut 2008/6 dhe nuk është plotësuar nga Ankuesja siç është kërkuar:

Ankesa e pakompletuar

Neni 60.2 i UA UNMIK-ut 2008/6 përcakton se ankesës duhet ti bashkëngjitet aktvendimi i Trupit Gjykses. Aktvendimi i Trupit Gjykses kundër të cilit është ngritur ankesa nuk i ishte bashkëngjitur ankesës. Kështu, ankesa nuk e plotëson kushtin e paraparë me nenin 60.2 të UA UNMIK-ut 2008/6 të shpjeguar.

Gjithashtu, sipas nenit 25.7 të UA UNMIK-ut 2008/6 parashtresat dhe dokumentet përcjellëse mund të paraqiten në gjuhën shqipe, serbe ose angleze. Por, nëse paraqiten në gjuhën shqipe ose serbe, duhet të sigurohet edhe përkthimi i të gjitha parashtresave dhe dokumenteve përcjellëse edhe në gjuhën angleze. Shpenzimet e përkthimit i heq pala. Ankesa është dorëzuar në gjuhën shqipe, por nuk është ofruar përkthimi i ankesës në gjuhën angleze.

Mosplotësimi i ankesës

Neni 61.4 i UA UNMIK-ut 2008/6 përcakton se pas pranimit të ankesës, DHPGJS-ja e shqyrton atë për të vlerësuar se a i plotëson ajo kushtet e kësaj UD-je. Nëse DHPGJS-ja vendos se ankesa nuk i plotëson këto kushte, ajo e urdhëron menjëherë ankuesin që të plotësojë ankesën e tij sipas kushteve të dhëna dhe brenda një kohe të arsyeshme, në të kundërtën ankesa do të refuzohet.

Ankesa duhet të plotësohet së paku sipas urdhrit për sqarim përkatës të gjykatës. Edhe pse Ankuesja është paralajmëruar për pasojat e mosplotësimi të kushteve, ajo nuk ka plotësuar ankesën e saj, e cila pra nuk i plotëson kriteret e pranueshmërisë së një ankese.

Kërkesa për ndihmë në përkthim

Edhe pse Ankuesja nuk e ka përdorur shabllonin e kërkuar për një kërkesë për ndihmë në përkthim, parashtresa e saj duhet të përkthehet si e një kërkesë e tillë. Kjo kërkesë duhet të refuzohet, pasi që Ankuesja nuk i ka ofruar gjykatës provat e nevojshme për të dëshmuar saktësinë e deklaratave të saja lidhur me gjendjen e saj financiare.

Në shkresat e lëndës është vetëm një përkthim në gjuhën angleze i padisë dhe i disa dokumenteve tjera, por jo edhe përkthimi i ankesës. Ankueses i është dhënë mundësia që të kërkojë ndihmë në përkthim duke përdorur formularin e kërkuar (ZPF 1). Qëllimi i shfrytëzimi të këtij formulari është që të ndihmojë në sqarimin e gjendjes së përgjithshme ekonomike të Ankueses për t'ia mundësuar gjykatës që të marrë vendim për kërkesën. Ankuesja deklaroi se ajo jeton me ndihmë sociale dhe se nuk ka të ardhura tjera apo ndonjë pronë. Vetëm kjo deklaratë pa plotësuar dhe dorëzuar formularin zyrtar dhe në veçanti pa ofruar (edhe pse është kërkuar në mënyrë eksplicite) ndonjë dëshmi mbështetëse nuk mjafton që asaj ti pranohet kërkesa për ndihmë në përkthim në bazë të nenit 25.8 të UA UNMIK-ut 2008/6. Kështu, kërkesa duhej të refuzohej.

Në bazë të nenit 25.9 të UA UNMIK-ut 2008/6 në lëndët si kjo gjykata duhet të sigurojë përkthimin ex officio, duke e ngarkuar më pas Ankuesin për shpenzimet e krijuara nga kjo. Siç ka përmendur kjo gjykatë më parë (shih ASC-10-0018),

qëllimi i zbatueshmërisë së kësaj dispozite është i kufizuar saktësisht për lëndët në të cilat kërkesat për ndihmë në përkthim nuk kanë pasur sukses. Fjalë 3 e dispozitës në fjalë dukshëm i referohet fjalës 2 ("përkthimet e tilla"). Neni 25.9 i UA UNMIK-ut 2008/6 nuk ka për qëllim të ruaj pozitën procedurale të atyre, të cilën nuk kujdesen fare për të drejtat e tyre procedurale duke kërkuar ndihmë në përkthim. Për këtë arsye ankesa do të përkthehej ex officio nëse do të kishte plotësuar kriteret tjera të pranueshmërisë.

Pasi që nuk i ka plotësuar (shih më lartë), nuk kishte asnjë arsye për të përkthyer dokumentet e dorëzuara.

Taksat gjyqësore

Për procedurat e ankimeve vlejnë taksat gjyqësore në vijim (shih ASC -09-0072 et al):

Tarifat e taksave gjyqësore, neni 10.11 (ushtrimi i ankesës)	30 Euro
Tarifat e taksave gjyqësore, neni 10.15 lidhur me 10.21 (aktvendimi në shkallën e dytë)	30 Euro
<u>Gjithsej</u>	<u>60 Euro</u>

Taksat gjyqësore do të barten nga Ankuesja, e cila është e obliguar që të paguaj për Dhomën e Posaçme shumë të lartpërmendur.

Richard Winkelhofer, Gjyqtar Kryesues i EULEX-it _____ nënshkruar _____

Torsten Frank Koschinka, Gjyqtar i EULEX-it _____ nënshkruar _____

Eija- Liisa Helin, Gjyqtare e EULEX-it _____ nënshkruar _____

Tobias Lapke, Regjistruer i EULEX-it _____ nënshkruar _____